

## STATUTI I LËVIZJES PËR BASHKIM (LB)

Lëvizja për Bashkim është subjekt politik që ka për qëllim bashkimin e popullit shqiptar në një shtet të vetëm.

### KAPITULLI I

#### EMRI, PËRKUFIZIMI, SHTRIRJA ORGANIZATIVE, SIMBOLET DHE VULA

##### EMRI, INICIALET, PËRPKUFIZIMI

###### Neni 1

- Emri i plotë i subjektit politik është: **Lëvizja për Bashkim**.
- Inicialet e lëvizjes janë: **LB**
- Lëvizja për Bashkim (në tekstin e mëtejshëm: LB) është organizim vullnetar i individëve me qëllime të njëjta politike.

##### SHTRIRJA DHE SELIA

###### Neni 2

- LB-ja ka shtrirje organizative në Kosovë.
- Selia e LB-së është në Prishtinë.

##### SIMBOLI

###### Neni 3

- Simboli i LB-së është i përbërë nga një shirit i kuq nën të cilin është e shkruar LËVIZJA PËR BASHKIM, përgjatë gjithë gjatësisë së shiritit, në sfondin e bardhë e me shkronja të zeza, me dimensionin vertikal të shkronjave të barabartë me dimensionin e gjerësisë së shiritit.
- Përdorimi i simbolit rregullohet me *rregullore të veçantë të Këshillit të Përgjithshëm*.

## VULA

### Neni 4

LB-ja e ka vulën e saj, e cila është në formë rrethore, brenda së cilës formë përgjatë krejt harkut rrethor shënohet dy herë në trajtë simetrike *Lëvizja për Bashkim*, ndërsa në mes shënohet akronimi *LB*. Diametri i saj është tri centimetra.

## KAPITULLI II

### DOKUMENTET THEMELORE TË LB-së

#### Neni 5

1. Dokumentet themelore mbi të cilat bazohet funksionimi i LB-së janë Programi dhe Statuti i saj.
2. Programi dhe Statuti janë dokumente të hapura për ndryshime.
3. Programin dhe Statutin e miraton dhe mund ta ndryshojë vetëm Kuvendi i LB-së\*.

## KAPITULLI III

### PARIMET KRYESORE ORGANIZATIVE

#### Neni 6

LB-ja është krijuar, është organizuar e funksionon mbi bazën e disa parimeve kryesore:

- a. organizimi mbi baza territoriale;
- b. demokracia e brendshme;
- c. liria e shprehjes e çdo anëtarë për çdo problem që ka të bëjë me LB-në, me të zgjedhurit e saj, me dokumentet programore e statutare dhe me zbatimin e tyre, si dhe me çështje të tjera me interes;
- d. pacenueshmëria e personalitetit dhe dinjitetit të çdo anëtarë;
- e. kolegjaliteti dhe transparenca në marrje të vendimeve dhe në drejtimin e çdo strukture të LB-së;
- f. respektimi i vendimeve të shumicës pas shterimit të debatit;

---

\* Shih Nenin 19 të këtij Statuti!

- g. përfaqësimi dhe vlerësimi i secilit në bazë të kontributit;
- h. vendimet dhe qëndrimet politike merren me votim të hapur;
- i. organet e LB-së zgjidhen me votim të fshehtë. Në rastet kur është një kandidat, organi përkatës mund të vendosë për zgjedhje me aklamacion.

## KAPITULLI IV

### ANËTARËSIMI, DETYRAT DHE TË DREJTAT E ANËTARIT TË LB-së

#### ANËTARËSIMI

##### Neni 7

1. Anëtar i LB-së mund të jetë çdo person i cili:
  - a) e ka mbushur moshën 18 vjeç;
  - b) e pranon me vullnet të lirë Programin dhe Statutin e LB-së;
  - c) nuk është anëtar i një subjekti tjetër politik;
  - d) bën pjesë në strukturën organizative të LB-së ose mban lidhje me të.

##### Neni 8

1. Anëtari i LB-së paguan anëtarësi të rregullt mujore. Kuotizacioni i anëtarësisë përcaktohet nga Këshilli i Përgjithshëm i LB-së.
2. Anëtari i LB-së pajiset me librezë anëtarësie sipas rregullave të parapara nga Këshilli i Përgjithshëm i LB-së.
3. Anëtarëve të LB-së të cilët jetojnë jashtë territorit të Kosovës iu garantohet përfaqësim në Kuvendin e LB-së. Mënyra e përfaqësimit në Kuvendin e LB-së dhe e zhvillimit të jetës politike përcaktohet me *vendim të Këshillit të Përgjithshëm*.
4. Anëtari i LB-së i cili për arsye personale është i detyruar të largohet nga territori i Kosovës, mund ta ruajë anëtarësinë duke e njoftuar me shkrim degën për adresën e tij të re, si dhe duke e shprehur zotimin për angazhim në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky Statut.

## DETYRAT E ANËTARIT

### Neni 9

1. Anëtari i LB-së ka për detyrë:
  - a. të punojë aktivisht në zbatimin e Programit të LB-së;
  - b. ta respektojë disiplinën e LB-së dhe të kontribuojë në forcimin e saj;
  - c. të marrë pjesë në zgjedhjet në LB, duke votuar për kandidatin që dëshiron;
  - d. t'i pranojë dhe t'i zbatojë vendimet e shumicës;
  - e. t'i respektojë mendimet ndryshe, por duke iu përmbajtur gjithmonë vendimeve të shumicës;
  - f. të punojë për rritjen e ndikimit të LB-së;
  - g. ta paguajë rregullisht anëtarësinë.

## TË DREJTAT E ANËTARIT

### Neni 10

1. Anëtari i LB-së ka të drejtë:
  - a. të marrë pjesë dhe ta japë kontributin e tij në hartimin dhe zbatimin e qëndrimeve dhe politikave të LB-së, Programit dhe Statutit të saj;
  - b. të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese të LB-së;
  - c. të informohet për aktivitetin e strukturave të LB-së dhe ta shprehë qëndrimin e tij mbi to;
  - d. të largohet nga LB-ja pa qenë i detyruar të japë shpjegime për këtë çështje.

## KAPITULLI V

### ORGANIZIMI

#### Neni 11

1. LB-ja e ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Kosovës dhe është e organizuar në dy nivele: në nivelin lokal dhe në atë qendror.
2. Në nivelin lokal LB-ja e ka këtë organizim:
  - kuvendi i degës;
  - këshilli i degës;
  - kryesia e degës;

- kryetari i degës;
  - këshilli qytetar;
  - kryesia e këshillit qytetar;
  - kryetari i këshillit qytetar.
3. Në nivelin qendror LB-ja e ka këtë organizim:
- Kuvendi i LB-së;
  - Këshilli i Përgjithshëm i LB-së;
  - Kryetari i LB-së;
  - Kryesia e KP të LB-së.

## ORGANIZIMI I LB-së NË NIVEL LOKAL

### *KUVENDI I DEGËS*

#### Neni 12

1. Kuvendi i degës është organi më i lartë vendimor i LB-së në nivel dege.
2. Kuvendi i degës përbëhet nga:
  - a. të gjithë anëtarët e këshillit të degës;
  - b. delegatë nga të gjitha këshillat qytetare, të cilët zgjidhen në bazë të kriterëve të përcaktuara me *vendim të veçantë të Këshillit të Përgjithshëm*.
3. Kuvendi i degës thirret të paktën një herë në katër vjet.
4. Kuvendi i degës thirret me vendim të këshillit të degës.
5. Për mbledhjen e kuvendit të degës, për vendin e mbajtjes, për materialet e punës dhe për rendin e ditës, anëtarët e kuvendit të degës njoftohen së paku 15 ditë përpara mbajtjes së tij.
6. Përgatitja e kuvendit të degës dhe punimet e tij bëhen sipas *rregullores së veçantë të KP-së*.
7. Kuvendi i degës zgjedh:
  - a. anëtarët e këshillit të degës, sipas *rregullores së KP-së për organizimin e kuvendeve të degëve*;
  - b. delegatët për Kuvendin e LB-së.
8. Kuvend i jashtëzakonshëm i degës mund të thirret me kërkesën e 1/3 të të gjitha këshillave qytetare.
9. Kuvend i jashtëzakonshëm i degës thirret edhe në rast të cenimit të 2/3 të anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Degës.

## KËSHILLI I DEGËS

### Neni 13

1. Drejtimi politik dhe organizativ i LB-së në nivel dege ndërmjet dy kuvendeve të degës realizohet nëpërmjet këshillit të degës.
2. Mbledhjet e këshillit të degës thirren dhe drejtohen nga kryetari i degës.
3. Këshilli i degës zhvillon veprimtarinë e vet në bazë të *rregullores së veçantë* e cila miratohet nga Këshilli i Përgjithshëm.
4. Këshilli i degës zgjedh kryetarin dhe anëtarët e kryesisë së degës.
5. Këshilli i degës diskuton dhe miraton programe pune në fusha të caktuara në përputhje me vendimet e kuvendit të degës.
6. Këshilli i degës mund të kooptojë anëtarë të rinj, por gjithmonë duke ruajtur 2/3 e anëtarëve të zgjedhur në kuvend.
7. Këshilli i degës vendos thirrjen e kuvendit të degës në bazë të *rregullores së veçantë të KP-së*.

## KRYESIA E DEGËS

### Neni 14

1. Kryesia e degës organizon punën dhe veprimtarinë e përditshme të degës së LB-së.
2. Kryesia e degës e zhvillon aktivitetin e saj mbi bazën e *rregullores së veçantë të KP-së*.
3. Numri i anëtarëve të kryesisë së degës caktohet nga këshilli i degës mbi bazën e *rregullores së veçantë të KP-së*.
4. Anëtarët e kryesisë së degës zgjidhen nga radhët e anëtarëve të këshillit të degës për një periudhë 4-vjeçare nëpërmjet konkurrimit me kandidatura alternative.
5. Mbledhjet e Kryesisë së degës thirren nga kryetari i degës.

## KRYETARI I DEGËS SË LB-së

### Neni 15

1. Kryetari i degës është drejtuesi kryesor i degës së LB-së.
2. Kryetari i degës zgjidhet nga këshilli i degës.
3. Kryetari i degës zgjidhet me votim të fshehtë.
4. Kryetari i degës zgjidhet me votat e shumicës së anëtarëve të këshillit të degës.
5. Kryetari i degës ka për detyrë:
  - a. ta drejtojë dhe ta bashkërendojë veprimtarinë e përditshme të degës së LB-së;

- b. t'i thërrasë dhe t'i drejtojë mbledhjet e kryesisë së degës dhe të këshillit të degës;
- c. ta bashkërendojë punën e kryesisë së degës dhe të këshillit të degës.

## KËSHILLI QYTETAR

### Neni 16

1. Njësia bazë organizative e LB-së është këshilli qytetar i LB-së.
2. Këshilli qytetar formohet nga të paktën tre anëtarë të LB-së.
3. Zonën e veprimit të këshillit qytetar e miraton kryesia e degës.
4. Mbledhja e këshillit qytetar thirret nga kryetari i këshillit qytetar.
5. Këshilli qytetar i LB-së zgjedh delegatët e vet për kuvendin e degës.
6. Këshilli qytetar i LB-së gjatë ushtrimit të aktivitetit të vet ka për detyrë:
  - a. ta propagandojë politikën dhe qëndrimet e LB-së, në përputhje me Programin, Statutin dhe vendimet e organeve drejtuese të LB-së;
  - b. të angazhohet për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të përditshme të qytetarit në njësinë territoriale në të cilën vepron;
  - c. të punojë për shtimin e radhëve të LB-së;
  - d. të përpiqet ta zgjerojë ndikimin e LB-së në shtresat e ndryshme të popullsisë në njësinë territoriale në të cilën ai vepron.

## KRYESIA E KËSHILLIT QYTETAR

### Neni 17

1. Në rastin kur këshilli qytetar numëron mbi 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë, këshilli qytetar zgjedh kryesinë e këshillit.
2. Kryesia e këshillit qytetar organizon punën dhe veprimtarinë e përditshme të këshillit.

## KRYETARI I KËSHILLIT QYTETAR

### Neni 18

1. Kryetari i këshillit qytetar është përgjegjës për veprimtarinë e këshillit.
2. Kryetari i këshillit qytetar zgjidhet nga anëtarët e këshillit qytetar në prani të kryetarit të degës ose të njërit prej anëtarëve të kryesisë së degës.
3. Kryetari i këshillit qytetar ka për detyrë:
  - a. ta organizojë veprimtarinë e LB-së në territorin e veprimit të këshillit;

- b. t'i thërrasë mbledhjet e këshillit;
- c. ta njoftojë me shkrim kryesinë e degës për çdo mbledhje apo aktivitet të këshillit;
- d. ta azhurnojë listën e aktivistëve të LB-së të njësisë territoriale të këshillit.

## ORGANIZIMI I LB-së NË NIVEL QENDROR

### KUVENDI I LB-së

#### Neni 19

1. Kuvendi i LB-së është organi më i lartë vendimor i LB-së.
2. Kuvendi i LB-së përbëhet nga:
  - a. anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm nga përbërja e fundit;
  - b. delegatë nga të gjitha degët, në bazë të kriterëve të përcaktuara me *vendim të Këshillit të Përgjithshëm*;
  - c. përfaqësues të LB-së që jetojnë jashtë Kosovës, në bazë të kriterëve të përcaktuara me *vendim të KP-së*.
3. Kuvendi i LB-së thirret të paktën një herë në katër vjet me *vendim të Këshillit të Përgjithshëm*.
4. Për mbledhjen e Kuvendit, vendin e mbajtjes, kohëzgjatjen dhe rendin e ditës, anëtarët e Kuvendit njoftohen të paktën një muaj përpara mbajtjes së tij.
5. Kuvendi i LB-së përgatitet nga Grupi për përgatitjen e Kuvendit, i cili themelohet me *vendim të Këshillit të Përgjithshëm*.
6. Kuvendi i LB-së i zhvillon punimet në bazë të *Rregullores së punës*, e cila miratohet nga Kuvendi i LB-së.
7. Kuvendi i LB-së drejtohet nga Kryesia e punës e Kuvendit, e cila zgjidhet nga anëtarët e Kuvendit mbi bazën e propozimit të Këshillit të Përgjithshëm dhe të delegatëve të Kuvendit.
8. Kuvendi i LB-së i ka këto detyra dhe përgjegjësi:
  - a. përcakton orientimet themelore politike dhe organizative të veprimtarisë së LB-së për periudhën katërvjeçare;
  - b. shqyrton dhe miraton Programin dhe Statutin;
  - c. zgjedh Kryetarin e LB-së;
  - d. përcakton numrin e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm;
  - e. zgjedh anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm.
9. Kuvend i Jashtëzakonshëm mund të thirret me kërkesën e 1/3 të të gjitha degëve ose me 2/3 e gjithë anëtarëve të KP-së.
10. Kuvend i jashtëzakonshëm i LB-së duhet të thirret:



- a. në rast të cenimit të 2/3 të anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Përgjithshëm;
- b. në rast të shkeljeve të rënda të përcaktuara në Paragrafin 1 të Nenit 23 nga ana e Kryetarit të LB-së dhe kur këtë shkelje e konstaton KP i LB-së.

## KËSHILLI I PËRGJITHSHËM I LB-së

### Neni 20

1. Drejtimi politik dhe organizativ i LB-së midis dy kuvendeve realizohet nëpërmjet Këshillit të Përgjithshëm.
2. Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm zgjidhen nga Kuvendi i LB-së për një periudhë katërvjeçare.
3. Këshilli i Përgjithshëm i ka këto detyra dhe përgjegjësi:
  - a. miraton rregullat e zhvillimit të zgjedhjeve në të gjitha nivelet dhe organet e LB-së;
  - b. diskuton dhe miraton programe pune në fusha të caktuara në bazë të vendimeve të Kuvendit;
  - c. miraton strukturën organizative të LB-së, në përputhje me statutin e LB-së;
  - d. vendos thirrjen e Kuvendit të LB-së, si dhe emëron Grupin për përgatitjen e Kuvendit;
  - e. miraton rregullore dhe udhëzime mbi mënyrën dhe praktikën e organizimit dhe funksionimit të LB-së;
  - f. krijon grupe të përhershme apo të përkohshme pune me anëtarë apo simpatizantë të LB-së për çështje të ndryshme;
  - g. miraton rregulla mbi mënyrën e përfaqësimit në Kuvend dhe mbi mënyrën e zhvillimit të jetës politike të anëtarëve të LB-së që jetojnë jashtë Kosovës;
  - h. miraton rregullat e përdorimit të vulës të LB-së;
  - i. miraton kuotizacionin e anëtarësisë;
  - j. miraton rregulla mbi aktivitetin financiar dhe ekonomik të LB-së;
  - k. në rast mosfunksionimi, thyerjesh të rënda disiplinore, apo të rezultateve të dobëta gjatë aktivitetit, vendos riorganizimin e pjesshëm ose të plotë të strukturës lokale të LB-së.
4. Këshilli i Përgjithshëm e zhvillon veprimtarinë e vet në bazë të *Rregullores së Punës së KP-së* e cila miratohet nga Këshilli i Përgjithshëm.
5. Mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm thirren me vendim të Kryetarit të LB-së. Vendi i mbajtjes, kohëzgjatja dhe rendi i ditës njoftohen të paktën 5 ditë përpara mbajtjes së saj.
6. Mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm drejtohen nga Kryetari i LB-së, apo, në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve të Kryesisë së KP të LB-së.
7. Mbledhjet e KP-së janë periodike dhe përcaktohen në Rregullore të punës së KP-së. Mbledhjet e jashtëzakonshme të KP-së mund të thirren me kërkesën e Kryetarit, ose me kërkesën e 1/3 të të gjithë anëtarëve të KP-së.
8. Këshilli i Përgjithshëm mund të bëjë kooptim të anëtarëve të rinj, por gjithmonë duke ruajtur 2/3 e të gjithë anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi i LB-së.

## KRYETARI I LB-së

### Neni 21

1. Kryetari i LB-së është drejtues politik dhe organizativ i LB-së ndërmjet dy kuvendeve të LB-së.
2. Kryetari i LB-së zgjidhet nga Kuvendi i LB-së.
3. Kryetari i LB-së i ka këto përgjegjësi:
  - a. drejton dhe bashkërendon veprimtarinë e përditshme të LB-së;
  - b. thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm të LB-së dhe të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të LB-së;
  - c. bashkërendon punën e KP-së dhe udhëheq punën e Kryesisë së KP të LB-së.
4. Në rast të mungesës së përhershme të Kryetarit të LB-së, KP i LB-së duhet të thërrasë kuvend të jashtëzakonshëm të LB-së.

## KRYESIA E KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM

### Neni 22

1. Kryesia e KP të LB-së është organ që zbaton vendimet e kryetarit dhe KP-së dhe njëkohësisht është organ këshillëdhënës.
- 2.
3. Kryesia e KP të LB-së zgjidhet nga Këshilli i Përgjithshëm.
4. Anëtarët e Kryesisë zgjidhen nga radhët e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm.
5. Anëtarët dhe strukturën e Kryesisë së LB-së i propozon Kryetari i LB-së.
6. Mbledhjet e Kryesisë thirren nga Kryetari i LB-së. Në rast të mungesës së Kryetarit, me autorizimin e tij, mbledhjet e Kryesisë i thërret njëri nga anëtarët e saj.
7. Kryesia e KP të LB-së e zhvillon aktivitetin e saj mbi bazën e *rregullores së veçantë*, e cila miratohet nga Këshilli i Përgjithshëm.

## KAPITULLI VI

### MASAT DISIPLINORE

#### Neni 23

1. Çdo anëtar që vepron në kundërshtim me Programin, Statutin apo vendimet e organeve të LB-së i nënshtrohet masave disiplinore.
2. Masat disiplinore janë:
  - a. këshillim;
  - b. qortim;
  - c. pezullim i anëtarësisë;
  - d. përjashtim.
3. Kërkesën për fillimin e procedurës për masë disiplinore ndaj anëtarit të LB-së ka të drejtë ta bëjë çdo organ a anëtar i LB-së.
4. Kërkesa për masë disiplinore në rastin e anëtarit apo kryetarit të këshillit qytetar i drejtohet kryesisë së degës, ndërsa vendimin e merr këshilli i degës.
5. Kërkesa për masë disiplinore ndaj anëtarit të këshillit të degës i drejtohet Kryetarit të LB-së, ndërsa vendimin e merr Këshilli i Përgjithshëm me shumicë të thjeshtë të votave.
6. Kërkesa për masë disiplinore ndaj anëtarit të KP-së i drejtohet Kryetarit të LB-së, ndërsa vendimi merret nga KP-ja, me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të KP-së.
7. Në rast të shkeljeve të rënda të përcaktuara në Paragrafin 1 të këtij Neni nga ana e Kryetarit të LB-së dhe kur këtë shkelje e konstaton KP i LB-së, duhet të thirret kuvend i jashtëzakonshëm i LB-së.

## KAPITULLI VII

### ANKESAT NDAJ VENDIMEVE

#### Neni 24

1. Ndaj vendimeve që merren nga organet e LB-së mund të parashtrihen ankesa, të cilat i drejtohen Këshillit të Përgjithshëm të LB-së dhe të cilat shqyrtohen nga po ky organ.
2. Të drejtën e ankesave ndaj vendimeve të marra nga organet e LB-së e kanë të gjithë anëtarët dhe organet e saj.
3. Këshilli i Përgjithshëm formon komisione për shqyrtimin e ankesave sa herë ta shohë të nevojshme.

## KAPITULLI VIII

### BURIMET FINANCIARE E MATERIALE DHE PËRDORIMI I TYRE

#### Neni 25

1. Burimet financiare të LB-së janë:
    - a. Fondi për mbështetjen e subjekteve politike;
    - b. të ardhurat nga kuotizacioni i anëtarësisë;
    - c. ndihma vullnetare të anëtarëve dhe përkrahësve të LB-së;
    - d. ndihma vullnetare nga organizata të ndryshme, duke përfshirë organizata të dyshuara për krim të organizuar.
  2. Veprimtaria financiare dhe ekonomike e LB-së drejtohet nga Këshilli i Përgjithshëm.
  3. Të paktën dy herë në vit, në mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm, përgjegjësi për financa paraqet një raport në lidhje me aktivitetin financiar dhe ekonomik të LB-së.
  4. Rregulla të hollësishme mbi aktivitetin financiar dhe ekonomik të LB-së miratohen nga Këshilli i Përgjithshëm.
- 

Kuvendi i LB-së, 13.6.2021